



Këshilli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI

Nr. 4474 Prot

Datë 18.06 / 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 27, date 18.06 / 2025

(Per miratimin e marrjes me qera të një ambienti për tu përdorur si magazinë e NSHP-së)

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, date 17.12.2015 "Per Vetqeverisjen Vendore", Neni 54, pika "g", , me propozim të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë , Keshilli i Bashkise Himarë,

VENDOSI:

1. Marrjen me qera të një objekti nje katësh me sipërfaqe rreth 300 m², për tu përdorur si magazinë për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë.
1. Ngarkohet per zbatimin e ketij vendimi Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
2. Ky vendim hyn ne fuqi pas shprehjes se ligjshmerise nga Prefekti i Qarkut Vlore.

Përgjegjës i Sektorit të Finances
Artemis KITO

KRYETAR I BASHKISË
Vangjel TAVO

Përgjegjës i Sektorit Juridik
Alban SAQELLARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
NDËRMARJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE HIMARË

Nr. 4474 Prot

Datë 18/06 / 2025

RELACION

(Per miratimin e marrjes me qera të një ambienti për tu përdorur si magazinë e NSHP-së)

Ky projekt vendimi qe paraqitet per miratim është rezultat i nevojave të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për të marrë me qera një ambient për magazinimin e bazes materiale veglave dhe paisjeve që përdoren nga ajo për kryerjen me sukses të detyrave dhe funksioneve të ngarkuara nga ana e juaj me vendimin nr.39, date 20.12.2024 “Per krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në vartësi të Bashkisë Himarë”.

Me shkresen tonë nr.299 prot, date 02. 06. 2025 i jemi drejtuar Bashkisë Himarë për të na vënë në dispozicion një ambient për ta përdorë si magazinë për bazën materiale, pajisjet dhe veglat e punës së NSHP-së. Nga ana e saj Bashkia Himarë me shkresën e saj nr.4138/1 prot, datë 18 .06. 2025 ka kthyer përgjigje duke u shprehur se për momentin nuk disponon në pronësi apo në përdorim të saj një ambient të tillë.

Në këto kushte ju drejtohem Ju për të miratuar marrjen me qera të një ambienti për ta përdorur për magazinimin e bazes materiale veglave dhe paisjeve që përdoren nga NSHP për kryerjen e funksionit të saj.

Me miratimin nga ana e juaj të këtij projekt vendimi dhe shprehjes më tej të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë, nga ana e jonë do të kryhen procedurat ligjore për sigurimin e këtij ambienti të domosdoshëm për realizimin e funksioneve tona.

Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Ekonomik

Artemis KITO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
DREJTORI

Nr. 299 Prot.

Himarë, më 2 / 06 / 2025

**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË LEJEVE, LICENSAVE DHE HAPËSIRAVE
PUBLIKE
BASHKIA HIMARË**

Për dijeni:


Z. VANGJEL TAVO
KRYETAR
BASHKIA HIMARË

Lënda: Kërkesë për ambient për tu përdorur si magazinë e NSHP-së Himarë.

Për kryerjen me sukses të detyrave dhe funksioneve të ngarkuara, nga ana e Këshillit të Bashkisë Himarë, me Vendimin nr. 39, date 20.12.2024 "Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në vartësi të Bashkisë Himarë", Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë kërkon, nga ana juaj, vënien në dispozicion të një ambienti në pronësi të Bashkisë Himarë për ta përdorur si magazinë për materialet ndërtimore, elektrike, hidraulike veglat dhe pajisjet e punës.

Sa më lart, shprehim besimin tonë në realizimin e kësaj kërkeje në një kohë sa më të shkurtër, për të bërë të mundur një ecuri normale të punëve nga ana e jonë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TE ASETETEVE

Nr. 4138/1 prot.

Himarë, më 18.06.2025

Lënda: Kthim përgjigjeje shkresës tuaj Nr.299 Prot., datë 02.06.2025

NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE
HIMARË

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.299 Prot., datë 02.06.2025 , për vënien në dispozicion të një ambienti për tu përdorur si magazine nga NSHP-ja Himarë ,ju informojmë se për momentin ,Bashkia Himarë nuk ka në dispozicion një ambient të përshtatshëm që përmbush kriteret e kërkuara për magazinim të materialeve ndërtimore , elektrike apo të pajisjeve te punës .

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!

KRYETARI I BASHKISË
Vangjel Tavo

ME DELEGIM DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI
Pervin Gjiku

